

Programi Zviceran për Bashkëpunim në Kosovë 2017-2020



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

**State Secretariat for
Economic Affairs SECO**

**Directorate of Political
Affairs DP**

Angazhimi i Zvicrës për Qytetarët e Kosovës

Duke filluar me ndihmën humanitare në vitin 1998, bashkëpunimi zviceran në vazhdimësi është zhvendosur në mbështetjen e proceseve të tranzicionit, duke zhvilluar në ndërkohë një partneritet të besueshëm midis dy vendeve, bazuar në interesa të përbashkëta.

Strategjia e Bashkëpunimit Zviceran 2017-2020 është e bazuar në frymën e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis qeverive të Zvicrës dhe Kosovës. Sot, Zvicra është partneri bilateral i tretë më i madh i zhvillimit në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i programit zviceran është të kontribuojë në progresin e Kosovës në rrugën e saj drejt integritimit rajonal dhe

evropian, duke promovuar një sistem politik demokratik, një shoqëri paqësore dhe të bashkuar, duke ofruar qasje gjithëpërfshirëse në shërbimet themelore, sundimin e ligjit dhe një ekonomi tregu gjithëpërfshirëse.

Programi zviceran për bashkëpunim për periudhën 2017-2020 fokusohet në temat kryesore si në vijim:

- Qeverisja demokratike dhe siguria njerëzore
- Ekonomia dhe punësimi
- Uji dhe përshtatshmëria ndaj ndryshimeve klimatike
- Shëndetësia



Qeverisja Demokratike dhe Siguria Njerëzore

Qeverisja demokratike dhe kultura e dialogut me qytetarët janë vendimtare për të ndërtuar një demokraci gjithëpërfshirëse në Kosovë.

Zvicra i mbështet autoritetet komunale në ofrimin e shërbimeve publike në një mënyrë më të përgjegjshme, transparente dhe efektive. Ajo gjithashtu inkurajon angazhimin

aktiv të qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset e krijimit të politikave. Në nivel kombëtar, fokusi është në institucionet gjithëpërfshirëse si promovues kryesorë të një kohezioni shoqëror, veçanërisht në lidhje me trajtimin e së kaluarës, të drejtave të njeriut, kërkimit të konsensusit politik dhe dialogun për normalizimin e raporteve me Serbinë.




Ekonomia dhe punësimi

Investimet vendore dhe të huaja janë jetike për avancimin e rritjes ekonomike dhe rritjen e mundësive për punësim.

Zvicra mbështet Kosovën në përmirësimin e mjedisit të biznesit, duke riorganizuar dhe lehtësuar ambientin e të bërit biznes.

Për më tepër, Zvicra kontribuon në arsimimin dhe aftësimin profesional me qëllim të ndërtimit të një sistemi funksional ku aftësitë e punëkërkuësve i plotësojnë kërkesat e tregut të punës.

Mbështetja zvicerane përmes programeve për udhëzime të karrierës dhe punësim rritë gjasat që të rinjtë të gjejnë punë, dhe nga ana tjetër, u ndihmon kompanive të angazhojnë njerëz të trajnuar në mënyrë adekuate.



Uji dhe përshtatshmëria ndaj ndryshimeve klimatike

Objektivi kryesor është të sigurohet qasje në shërbime të ujit dhe kanalizimit të cilësisë së lartë e me çmime të përballueshme që përmirësojnë jetesën.

Zvicra është duke punuar në këtë drejtim duke u angazhuar në dialog për politikëbërje, duke forcuar institucionet që menaxhojnë dhe qeverisin sektorin e ujit dhe duke investuar në rrjetet e ujit të pijshëm, siste-

met e kanalizimeve dhe fabrikat e trajtimit të ujërave të zeza.

Gjithashtu është duke punuar në ngritjen e përgjithshme të vetëdijësitë rreth përdorimit të përgjegjshëm të ujit. Përveç kësaj, shërbimet publike inkurajohen të jenë pjesë e përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatshmërinë e ndikimit të ndryshimeve klimatike.



Shëndetësia

Zvicra kontribuon në modernizimin e shërbimeve shëndetësore të Kosovës duke mbështetur themelimin e skemës së detyrueshme të sigurimeve shëndetësore. Në nivel lokal, programi synon të përmirësojë kujdesin shëndetësor duke rritur kapacitetet e stafit mjekësor dhe duke inkurajuar qytetarët që të kërkojnë shërbimet që janë në dispozicion.

Vëmendje e veçantë i kushtohet nevojave të grupeve të ndjeshme ose të përjashtuara. Forcimi i sistemit për parandalimin, trajtimin dhe menaxhimin e sëmundjeve jo të transmetueshme është një fushë e rëndësishme, si dhe rritja e vetëdijësimit në popullatë për shëndetin dhe inkurajimi për të kërkuar llogaridhënie brenda sistemit.



Migrimi

Zvicra ka një partneritet të migrimit me Kosovën që nga viti 2010. Programi synon të ndërtojë kapacitete midis autoriteteve të Kosovës për migrim me një sërë masash të synuara në politikën dhe menaxhimin e migrimit. Gjithashtu, ajo synon të adresojë mi-

grimin nëpërmjet përmirësimit të përfshirjes sociale të grupeve të marginalizuara, të cilët janë më të prirur për të migruar. Përveç kësaj, Zvicra hulumton mënyra për të inkurajuar kontributin e diasporës së Kosovës në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Modalitetet e Punës


Puna e Zvicrës bazohet në marrëveshjet formale me Qeverinë e Kosovës.

Programi zviceran për bashkëpunim në Kosovë përdor një kombinim të modaliteteve të zbatimit dhe bashkëpunimit me shumë palë të interesit, siç janë agjencitë shumëpalëshe dhe dypalëshe, autoritetet shtetërore,

OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, sektori privat dhe Institutet / Think Tanks. Gjatë zbatimit të programit, vëmendje e veçantë i kushtohet temave transversale: qeverisjes së mirë dhe barazisë gjinore.

Zotimi financiar për periudhën 2017-2020 është 85 milionë franka zvicerane.

Zotimet e planifikuara sipas temes dhe burimit të financimit 2017-2020



**pa shpenzimet për menaxhimin e zyres, përfshirë projektet e vogla/kreditit global ZZB

Botuesi

Redaktorët dhe Botuesit:

Departamenti Federal i Punëve të Jashtme
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
3003 Bern
Zvicër
<https://www.eda.admin.ch/deza/en/home.html>

Departamenti Federal i Çështjeve Ekonomike, Arsimit dhe Hulumtimit
Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO)
3003 Bern
Zvicër
<https://www.seco.admin.ch/seco/en/home.html>

Departamenti Federal i Punëve të Jashtme
Drejtoria Për Çështje Politike
Bundesgasse 32
3003 Bern
Zvicër
<https://www.eda.admin.ch/eda/en/home/fdfa/organisation-fdfa/directorates-divisions/directorate-political-affairs.html>

Ambasada e Zvicrës
Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Kosovë
Rene Dekarti 1
10060 Prishtinë
pristina@eda.admin.ch
<https://www.eda.admin.ch/pristina>

Strategjia Zvicerane për Bashkëpunim Kosovë 2017-2020 mund të gjindet në:

<https://www.eda.admin.ch/countries/kosovo/en/home/international-cooperation/strategy.html>

Dizajni:

Rrota, www.rrota.com

Fotot:

© Arben Llapashtica (kopertina)
© BoneVet (faqe 4)
© KALLXO.com (faqe 5)
© Layla Barakë/Swiss Cooperation Office Kosovo
(faqe: 2, 3, 4 dhe 6)